



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit  
të Kosovës

+383 49 738 080  
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"  
Blloku C3, Faza 2  
Str: Radovan Zogoviq  
10 000 Prishtina

# RREGULLORE PËR ANTI-DOPING NË BASKETBOLL

Prishtinë, 03.10.2022

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





## PËRMBAJTJA:

<b>NENI 1 - QËLLIMI I RREGULLORES .....</b>	<b>3</b>
<b>NENI 2 - FUSHËVEPRIMI .....</b>	<b>3</b>
<b>NENI 3 - RREGULLAT ANTI-DOPING.....</b>	<b>3</b>
<b>NENI 4 - ROLET DHE PËRGJEGJËSITË PLOTËSUESE TË FBK-SË .....</b>	<b>5</b>
<b>NENI 5- KODI BOTËROR ANTI-DOPING 2021 .....</b>	<b>6</b>
<b>NENI 6 - SHKELJET E RREGULLAVE ANTI-DOPING .....</b>	<b>6</b>
<b>NENI 7- KËSHILLAT KRYESORE PËR SPORT TË PASTËR.....</b>	<b>7</b>
<b>NENI 8 - LISTA E NDALUAR .....</b>	<b>7</b>
<b>NENI 9 - KONTROLLIMI I MEDIKAMENTEVE .....</b>	<b>8</b>
<b>NENI 10 - PËRDORIMI I SUPLEMENTEVE USHQYESE.....</b>	<b>8</b>
<b>NENI 11 - APLIKIMI PËR NJË PËRJASHTIM PËR PËRDORIM TERAPEUTIK (TUE).....</b>	<b>9</b>
<b>NENI 12 - ÇFARË NDODH NË NJË TEST? .....</b>	<b>9</b>
<b>NENI 13 - MBRONI SPORTIN TUAJ.....</b>	<b>9</b>
<b>NENI 14 - BASHKËPUNIMI ME FIBA-N .....</b>	<b>10</b>
<b>NENI 15 - RAPORTIMI .....</b>	<b>10</b>
<b>NENI 16 - VETËDIJËSIMI.....</b>	<b>10</b>
<b>NENI 17 - ZBATIMI .....</b>	<b>10</b>
<b>NENI 18 - DISPOZITA PËRFUNDIMTARE.....</b>	<b>11</b>

### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





Mbështetur në Nenin 23 të Statutit të Federatës së Basketbollit të Kosovës, Bordi i FBK-së, më 03.10.2022 në Prishtinë, miraton këtë:

## RREGULLORE PËR ANTI-DOPING NË BASKETBOLL

### NENI 1 - QËLLIMI I RREGULLORES

1. Të gjithë sportistët kanë të drejtë të garojnë në sport, gjithnjë duke u nisur nga fakti se ata dhe konkurrentët e tyre duhet të jenë të pastër. Ne besojmë në sportin e pastër dhe punojmë në partneritet me Agjencinë Kosovare të Anti-Dopingut (KosADA) dhe Federatën Ndërkombëtare të Basketbollit (FIBA) për të siguruar që integriteti i sportit tonë të mbrohet.
2. Rregullat e anti-dopingut përfaqësojnë konsensus të një spektri të gjerë të palëve të interesuara në mbarë botën lidhur me atë që është e nevojshme për të mbrojtur dhe siguruar sportin e drejtë.
3. Programet e Anti-dopingut janë të bazuara në 'frymën e sportit', pra në zhvillimin etik të përsosmërisë njerëzore përmes dedikimit në zhvillimin e talenteve natyrore të sportistëve.
4. Duke mbrojtur shëndetin e Sportistëve, programet anti-doping synojnë që të ruajnë integritetin e sportit në drejtim të respektimit të rregullave, konkurrentëve të tjerë, konkurrencës së ndersme, fushës së barabartë të lojës dhe vlerës së sportit të pastër në botë.

### NENI 2 - FUSHËVEPRIMI

Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen nga Federata e Basketbollit të Kosovës, klubet dhe anëtarët e FBK-së.

### NENI 3 - RREGULLAT ANTI-DOPING

1. Federata e Basketbollit të Kosovës (FBK) ka vendosur të integroj një sërë rregullash anti-doping, të cilave duhet t'u përmbahen të gjithë sportistët dhe mbështetësit e sportistëve.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit  
të Kosovës

+383 49 738 080  
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"  
Blloku C3, Faza 2  
Str: Radovan Zogoviq  
10 000 Prishtina

**2.** Rregullat anti-doping për FBK-në janë në përputhje me Kodin Botëror Anti-Doping (Kodi), dokumenti që harmonizon politikat, rregullat dhe rregulloret antidoping brenda sportit globalisht, si dhe me Rregulloren e Brendshme të FIBA-s mbi Anti-Dopingun, e cila konsiderohet si pjesë integrale e kësaj Rregullore të FBK-së:

<https://www.fiba.basketball/internal-regulations/book4/anti-doping.pdf>.

**3.** FBK njeh kompetencën dhe përgjegjësitë e KosADA-s për zbatimin e programit Kombëtar Anti-Doping të Kosovës dhe rrjedhimisht Rregullat për Anti-doping të FBK-së janë rregullat e publikuara nga KosADA (ose pasardhësi i kësaj agjencie), të cilat mund të amandamentohen herë pas here, sipas nevojës.

**4.** Të gjithë anëtarët e FBK-së (klubet, ekipet nacionale, shkollat e basketbollit, sportistët, trajnerët, gjyqtarët, vëzhguesit etj) duhet të respektojnë këto rregulla, pavarësisht se në çfarë niveli të garave marrin pjesë.

**5.** Rregullat Anti-Doping të Kosovës mund ti gjeni në linkun:

[https://www.noc-kosovo.org/repository/docs/rregullat\\_kombetare\\_antidoping\\_kosada.pdf](https://www.noc-kosovo.org/repository/docs/rregullat_kombetare_antidoping_kosada.pdf).

**6.** Në anti-doping, sportistët janë përgjegjës për veprimet e tyre: duke përfshirë atë se me çfarë ushqehen dhe se çfarë konsumojnë për të pirë. Ky njihet si parimi i "përgjegjësisë strikte".

**7.** Sportistët mund të testohen në çdo kohë, në çdo vend.

**8.** Dështimi për t'iu përmbajtur vlerave të sportit të pastër ose Rregullave Anti-Doping mund të nënkuptojë pasoja të rënda për të ardhmen apo karrierën tuaj sportive.

**9.** Sportistët e kanë përgjegjësinë për t'u siguruar që çdo gjë që e konsumoni për tu ushqyer apo për të pirë është pa ndonjë substancë të

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





ndaluar. Zhvillimi i zakoneve të mira për sport të pastër do të ndihmojë të ardhmen e sportit.

**10.** Sportistët dhe mbikëqyrësit e tyre duhet ti kuptojnë plotësisht Rregullat Anti-Doping, pasojat e mos-sjelljes në përputhje me këto rregulla dhe vlerat e sportit të pastër.

**11.** Të gjithë sportistët që përgatiten ose marrin pjesë në një garë ose aktivitet të autorizuar ose organizuar nga FBK ose një nga organizatat anëtare të saj, dhe i gjithë Personeli Mbështetës i Sportistëve, duhet të pranojnë detyrimet që rrjedhin nga kjo Rregullore, dhe t'i nënshtrohen kompetencës së Menaxhimit të Rezultateve dhe KosADA-s si kusht për pjesëmarrjen e tillë.

**12.** Pavarësisht nënshkrimit të kësaj marrëveshje, të gjithë sportistët, personeli mbështetës i sportistëve dhe personat e tjerë nën juridiksionin e FBK-së, duhet nënshtruar këtyre Rregullave.

#### **NENI 4 - ROLET DHE PËRGJEGJËSITË PLOTËSUESE TË FBK-SË**

**1.** Sa i përket veprimeve që FBK ndërmerr për të zbatuar përputhshmërinë me Kodin, Standardet Ndërkombëtare (standarde të miratuara nga WADA krahas Kodit), dhe Rregullat e Brendshme mbi Anti-dopingun të FIBA-s, ndër kryesoret janë:

**1.1.** Kryerja e testimit bëhet vetëm nën kompetencën e dokumentuar të FIBA-s dhe përmes KosADA-s ose autoriteteve të tjera për marrjen e mostrave në përputhje me Standardet Ndërkombëtare për testimin dhe hetimet;

**1.2.** Njohja e autoritetit të KosADA-s dhe, sipas rastit, asistimi sa i përket zbatimit të programit kombëtar të testimit;

**1.3.** Analiza e të gjitha mostrave duke përdorur laboratore të akredituara nga WADA ose të aprovuar nga WADA në përputhje me nenin 6.1 të Rregullave të Brendshme mbi Anti-dopingun të FIBA-s;

#### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





**1.4.** Siguria se çdo rast i shkeljes së rregullave të anti-dopingut në nivel kombëtar të zbuluar nga FBK do të gjykohet nga një panel dëgjimor i pavarur në përputhje me nenin 8.1 të Rregullave të Brendshme mbi Anti-dopingun të FIBA-s dhe me Standardet Ndërkombëtare për Menaxhimin e Rezultateve.

**1.5.** Rregulla disiplinore për të parandaluar personelin mbështetës të sportistëve të cilët përdorin substanca ose metoda të ndaulara pa justifikim të vlefshëm, që të ofrojnë mbështetje për sportistët nën autoritetin e FIBA-s ose FBK-së.

## NENI 5- KODI BOTËROR ANTI-DOPING 2021

**1.** Nga 1 Janari 2021, një version i ri i Kodit është në fuqi dhe është e rëndësishme që të gjithë sportistët dhe mbështetësit e sportistëve të jenë të vetëdijshëm se si kjo ndikon tek ata.

**2.** Për më shumë informacion mbi ndryshimet brenda Kodit 2021, vizitoni faqen e internetit World Anti-Doping Code:  
<https://www.wada-ama.org/en/resources/world-anti-doping-program/world-anti-doping-code>.

**3.** Sipas Kodit 2021, një sportist mund të klasifikohet si "Niveli Ndërkombëtar", "Niveli Kombëtar" ose "Sportist Rekreativ" bazuar në nivelin e tyre të garimit. Informacionet për kategori të ndryshme janë të disponueshme në linkun e lartpërmendur.

## NENI 6 - SHKELJET E RREGULLAVE ANTI-DOPING

Thyerja e rregullave anti-doping mund të rezultojë në një ndalim nga të gjitha sportet. Kodi përshkruan Shkeljet e Rregullave Anti - Doping (ADVR). Sportistët dhe mbështetësit e tyre duhet të sigurohen që të jenë plotësisht të vetëdijshëm për këto shkelje, si dhe për pasojat e shkeljes së tyre.

### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





## NENI 7- KËSHILLAT KRYESORE PËR SPORT TË PASTËR

**1.** Një sportist është përgjegjës për çdo gjë që gjendet në sistemin e tyre, pavarësisht se si ka arritur atje ose nëse ka ndonjë qëllim për të mashtruar. Të gjithë sportistët dhe mbështetësit e tyre duhet të ndërgjegjësohen për rreziqet, në mënyrë që të mos marrin një ndalim të paqëllimshëm nga sporti.

**2.** Për më shumë informata edukative vizitoni:

**2.1.** Programin edukativ të FIBA-s kundër dopingut përmes linkut:  
<https://www.fiba.basketball/anti-doping/anti-doping-education>;

**2.2.** Listën e Substancave të Ndaluar dhe Metodave të Shoqatës Botërore për Anti-Doping (WADA) përmes linkut:  
<https://www.fiba.basketball/anti-doping>; dhe

**2.3.** Platformën E-Learning e WADA-s përmes linkut:  
<https://adel.wada-ama.org/learn>.

## NENI 8 - LISTA E NDALUAR

**1.** Të gjitha substancat dhe metodat e ndaluara në sporte në përputhje me Kodin janë të përshkruara në Listën e Ndaluar.

**2.** Lista e Ndaluar menaxhohet dhe koordinohet nga WADA, e gjetur në faqen e internetit të WADA-s këtu:

<https://www.wada-ama.org/en/news/wada-publishes-2022-prohibited-list>.

**3.** Lista përditësohet çdo vit, duke hyrë në fuqi më 1 Janar. Është e mundur që WADA të bëjë ndryshime në Listë më shumë se një herë në vit, por ata duhet t'i komunikojnë këto ndryshime tre muaj përpara se të hyjnë në fuqi.

### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





4. Derisa kjo listë përditësohet çdo vit, sportistët dhe mbështetësit e tyre, duhet të sigurohen që ta kontrollojnë atë përpara se të hyjë në fuqi.

## NENI 9 - KONTROLLIMI I MEDIKAMENTEVE

1. Para marrjes së ndonjë medikamenti (qoftë nga një mjek apo i blerë pa recetë), sportistët duhet të kontrollojnë për t'u siguruar që ai nuk përmban ndonjë substancë të ndaluar.
2. Medikamentet (përbërësit ose emri i markës) mund të kontrollohen në internet në <https://www.globaldro.com/search>.
3. Është e rëndësishme të theksohet se medikamentet e blera në një vend mund të përmbajnë përbërës të ndryshëm të të njëjtit medikament të markës në një vend tjetër.

## NENI 10 - PËRDORIMI I SUPLEMENTEVE USHQYESE

1. WADA këshillon gjithmonë një qasje të kujdesshme ushqimore ndaj të ushqyerit, pasi nuk ka garanci që çdo produkt shtesë është i lirë nga substanca të ndaluara.
2. Sportistët mund të mbështesin trajnimin dhe përparimin e tyre drejt objektivave të tyre duke ngrënë dhe shijuar ushqim me vlera ushqyese.
3. Me pak planifikim, është e mundur që të ushqeheni me një dietë të shijshme dhe të shëndetshme të përberë nga një shumëllojshmëri e llojeve të ushqimit në kohën e duhur dhe në sasi të duhura.
4. Sportistët duhet të vlerësojnë nevojën, rreziqet, dhe pasojat përpara se të vendosin të marrin një shtesë dhe nëse duhet ta përdorin një të tillë.
5. Në faqen e internetit <https://sport.wetestyourtrust.com/> ju mund të kontrolloni nëse suplementet janë testuar.

### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:







## NENI 11 - APLIKIMI PËR NJË PËRJASHTIM PËR PËRDORIM TERAPEUTIK (TUE)

1. Nëse një sportist me një gjendje mjekësore legjitime duhet të përdorë një substancë ose metodë të ndaluar, ai do të duhet të aplikojë për një **përrjashtim për përdorim terapeutik (TUE)**. Kjo pranohet vetëm nëse nuk ka medikamente ose trajtime të tjera të përshtatshme të lejuara që mund të përdoren, dhe ekziston një proces i rreptë dhe i detajuar për ta përcaktuar këtë.

2. Sportistët mund të mësojnë më shumë rreth procesit TUE në faqen e internetit:

<https://www.wada-ama.org/en/athletes-support-personnel/therapeutic-use-exemptions-tues>.

3. Sportistët që janë të përfshirë në një garë ndërkombëtare të FIBA-s duhet të ndjekin FIBA TUE procesin. Për më shumë informacion <https://www.fiba.basketball/anti-doping/tue>.

## NENI 12 - ÇFARË NDODH NË NJË TEST?

Aletët duhet të ndihen të përgatitur dhe të dinë të drejtat e përgjegjësitë e tyre kur janë të informuar për t'u testuar nga një drejtues ose zyrtar i kontrollit të dopingut. Shikoni këtë video më poshtë mbi procesin e testimit nga fillimi në fund:

[https://www.youtube.com/ëatch?v=XzOnQBK\\_YZo](https://www.youtube.com/ëatch?v=XzOnQBK_YZo)

## NENI 13 - MBRONI SPORTIN TUAJ

1. Mbrojtja e sportit të pastër varet nga të gjithë që luajnë rolin e tyre, sportistët, trajnerët ose prindërit - qoftë në skenën qendrore apo në prapaskenë.

2. Nëse mendoni se ka diçka të gabuar, sado e vogël ju mund të kontaktoni në email adresën **spocperson@basketbolli.com** dhe FBK ju garanton se identiteti juaj do të mbahet 100% konfidencial.

### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





**3.** Po ashtu ju mund të raportoni tek FIBA, më saktësisht Raportimi Konfidencial i FIBA-s: <https://www.fiba.basketball/integrity>.

Përditësimet e FIBA-s: <https://www.fiba.basketball/anti-doping/for-players>.

## NENI 14 - BASHKËPUNIMI ME FIBA-N

FBK do të bashkëpunojë dhe mbështes FIBA-n në këtë proces, dhe do të njohin, respektojnë, dhe zbatojnë vendimet e marra në përputhje me Rregullat e Brendshme të FIBA-s mbi Anti-Dopingun, duke përfshirë edhe vendimet që vendosin sanksione ndaj personave nën autoritetin e tyre.

## NENI 15 - RAPORTIMI

FBK do të raportojë çdo informacion që sugjeron ose lidhet me një shkelje të rregullave anti-doping tek FIBA dhe tek KosADA dhe do të bashkëpunojë me hetimet e kryera nga cilado Organizatë e anti-dopingut e cila është e autorizuar të kryej hetimet.

## NENI 16 - VETËDIJËSIMI

FBK do të angazhohet të ofrojë edukim kundër Dopingut në koordinim me KosADA-n.

## NENI 17 - ZBATIMI

**1.** Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen nga Federata e Basketbollit e Kosovës, klubet dhe anëtarët e FBK-së.

**2.** Dispozitat e kësaj Rregullore po ashtu mund të zbatohen drejtpërdrejtë nga FIBA në lidhje me Atletët (përfshirë atletët e nivelit kombëtar) dhe me persona të tjerë nën autoritetin e tyre anti-doping, siç specifikohet në Hyrjen e Rregullave të Brendshme lidhur me Anti-Dopingun të FIBA-s (pika 'Fushëveprimi i Rregullave Anti-Doping').

### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit  
të Kosovës

+383 49 738 080

federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"  
Blloku C3, Faza 2  
Str: Radovan Zogoviq  
10 000 Prishtina

## NENI 18 - DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Bordi Ekzekutiv i FBK-së.
2. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje i propozon Sekretari i Përgjithshëm, të cilat i miraton Bordi i FBK-së.

Në emër të Bordit Ekzekutiv të FBK-së,

Arben **FETAHU**  
Kryetar



Federata e Basketbollit e Kosovës

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:

